



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE


AMP
(Ish-SHÇBA)

Rruga "Asim Vokshi", Nr.19/1, Tiranë



**RAPORTI
VJETOR**

2021



Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm

Ky raport shënon fundin e një viti të ngarkuar me sfida të shumta, si në aspektin e përmbushjes së detyrimeve ligjore për garantimin e zbatimit të ligjit nga subjektet e institucioneve që janë objekt i veprimtarisë së Agjencisë, ashtu edhe në aspektin e mirëfunksionimit të strukturave tona nën kushtet e imponuara nga pandemia e Covid 19.

Jam i lumtur që pas një bashkëpunimi rigoroz dhe të pandërprerë me të gjithë partnerët, aktorët dhe grupet e punës të përfshirë në projektin për hartimin e ligjit të ri të Agjencisë, përpjekjet tona u kurorëzuan me miratimin në Kuvendin e Shqipërisë të Ligjit Nr. 128/2021 "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", i cili e shndërroi SHÇBA-në në një Agjenci bashkëkohore, brenda standardeve të organizatës së Partnerëve Europian Kundër Korrupsionit (EPAC).

Përveç punës voluminoze në funksion të ligjit të ri, strukturat e Agjencisë në qendër dhe në qarqe kanë përmbushur me sukses detyrimet e tyre në aspektin e hetimit të veprimtarive të kundraligjshme, inspektimeve dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve për punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe strukturave të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin.

Rritja e cilësisë së shërbimit policor është padyshim edhe rezultat i rekomandimeve cilësore të dhëna nga strukturat e inspektimit në AMP, e cila gjatë vitit 2021 ka kryer 110 inspektime në 72 struktura dhe ka dhënë më shumë se 439 rekomandime. Për më tepër, gjatë këtij viti janë dërguar 224 referime penale për 329 persona pranë organeve të Prokurorive të Shkallës së Parë në rrethe, duke garantuar zbatimin e ligjit me paanshmëri të plotë.

Nga ana tjetër, janë 1694 ankesa nga qytetarët dhe institucione të tjera, të cilat janë trajtuar si në aspektin e hetimit administrativ të ankesave dhe inspektimeve, ashtu edhe në atë të hetimit penal të shkeljeve të ligjit nga punonjës të strukturave që janë objekt i veprimtarisë. Bashkëpunimi me qytetarët ka qenë një faktor kyç për realizimin me sukses të misionit të Agjencisë, por edhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike ndërinstitutionale në kuadër të proceseve integruese në Bashkimin Europian, sikurse edhe prioritetet, objektivat dhe synimet tona për vitin 2022.

Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve tanë ka qenë gjithmonë në fokus kryesor, pasi kjo ndihmon jo vetëm për kryerjen me përgjegjësi, integritet dhe profesionalizëm të detyrave të përditshme, por gjithashtu i jep një vlerë të shtuar institucionit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e besimit të publikut. Për këtë arsye, në bashkëpunim me disa institucione shtetërore, organizata të shoqërisë civile dhe homologë tanë të huaj, përgjatë gjithë vitit 2021 janë kryer trajnime të vazhdueshme të të gjitha strukturave në qendër dhe në qarqe, gjë e cila ka rritur ndjeshëm cilësinë e rezultateve të të gjithë sektorëve.

Një aspekt tjetër mjaft i rëndësishëm për t'u përmendur është edhe investimi që është kryer në fushën e teknologjisë së informacionit për rritjen e parametrave të sigurisë dhe zhvillimin e sistemeve kompjuterike, pjesë e vizionit tonë për t'ju përgjigjur dinamikës dhe kërkesave në rritje për sisteme të sigurt dhe të shpejta.

Vizioni ynë është krijimi i një strukture profesionale, transparente dhe të paanshme për mbikëqyrjen e veprimtarisë së subjekteve që parashikon ligji, duke e përafuar me agjencitë e tjera homologe të BE-së, drejt një modeli më demokratik sipas standardeve të EPAC-ut, në aspektin e misionit, detyrave funksionale, përgjegjësi, ndërtimit strukturor dhe trajtimit të personelit

Falenderime të veçanta për strukturat e AMP, Ministrinë e Brendshme dhe partnerët tanë nga programi ICITAP i Ambasadës së SHBA, të cilët n'a kanë mbështetur dhe udhëhequr në të gjitha përpjekjet tona për modernizimin e mëtejshëm të Agjencisë, duke çelur sëbashku një fazë të re të mbikëqyrjes policore, për një institucion më civil dhe bashkëkohor në shërbim të qytetarëve.



PASQYRA E LËNDËS

I.	VIJIMI I KONSOLIDIMIT ORGANIZATIV DHE FUNKSIONAL TË AGJENCISË SË RE TË MBIKËQYRJES POLICORE.....	5
II.	VLERËSIMI I SITUATËS.....	6
III.	REALIZIMI I PRIORITETEVE & OBJEKTIVAVE TË PLANIFIKUARA.....	6
IV.	PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE PËR INTEGRIMIN EVROPIAN & BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME SHËRBIMET HOMOLOGE.....	7
V.	MBIKËQYRJA NËPËRMJET VEPRIMTARISË INSPEKTUESE DHE TRAJTIMIT TË ANKESAVE.....	8
	V.1. Funksionimi i Linjës së Gjellbër	
	V.2. Administrimi i Ankesave	
	V.3. Ankesat sipas Shërbimeve të Strukturave, subjekte të Shërbimit	
	V.4. Ankesat sipas kategorisë së shkeljeve	
	V.5. Përfundimet e Hetimit Administrativ të Ankesave	
	V.6. Problematikat e konstatuara gjatë trajtimit të ankesave	
	V.7. Veprimtaria Inspektuese	
	V.8. Problematikat e konstatuara në inspektimet e zhvilluara	
VI.	MBIKËQYRJA NËPËRMJET HETIMIT PROCEDURAL PENAL.....	12
	VI.1. Operacione/Procedime Penale të suksesshme gjatë vitit 2021	
	VI.2. Ndarja dhe klasifikimi i veprave penale sipas hierarkisë & nivelit të menaxhimit	
	VI.3. Trendi i formave të paligjshmërive të evidentuara në periudhën 2019 – 2021	
VII.	ANALIZA E INFORMACIONIT KRIMINAL, SHFRYTËZIMI I PROGRAMEVE BASHKËKOHORE TË ANALIZËS.....	16
	VII.1. Mbikëqyrja nëpërmjet veprimtarisë së Sigurimit të Personelit (CSP)	
VIII.	INTEGRITETI/VETINGU I PUNONJËSVE TË AMP-SË DHE PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE.....	17
IX.	MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE.....	18
	IX.1. Për menaxhimin e shërbimeve logjistike & IT-së	
	IX.2. Për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimeve	
	IX.3. Performanca financiare	
X.	PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022.....	20



I. VIJIMI I KONSOLIDIMIT ORGANIZATIV DHE FUNKSIONAL TË AGJENCISË SË RE TË MBIKËQYRJES POLICORE

Si rezultat i një analize të hollësishme të veprimtarisë së institucionit, vlerësimit të jashtëm e të brendshëm, si dhe miratimit të “Strategjisë për zhvillimin e Shërbimit 2020 – 2024” dhe “Planit të Veprimit 2020 – 2022”, tashmë Shërbimi është ngritur në nivelin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, miratuar me ligjin nr. 128/2021.

Miratimi i ligjit të ri është mbështetur në nevojën për një reformim rrënjësor në përputhje me standardet e EPAC-ut, (Partnerët European Kundër Korrupsionit), si dhe synimit për përmbushjen e objektivave afatgjatë të përcaktuara në Programin e Qeverisë Shqiptare.

Ndërtimi i Agjencisë është mbështetur në çdo hap të tij nga Programi ICITAP, i cili ka suportuar jo vetëm nevojën për një ligj të ri, por edhe nevojën për forcimin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si një mekanizëm mbikëqyrës i strukturave ligjzbatuese të Ministrisë së Brendshme (Policia e Shtetit, Garda e Republikës, SHMNZSH).

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore do t'i japë mundësi:

- reformimit të institucionit, si një agjenci inteligjente për të luftuar korrupsionin, si dhe për të parandaluar veprimtarinë e kundërligjshme në radhët e subjekteve të Agjencisë, duke e përafruar atë me agjencitë e tjera homologe të BE-së.
- transformimit drejt një modeli më demokratik sipas standardeve të EPAC-ut, si në aspektin e misionit, ashtu edhe në drejtim të përcaktimit të detyrave funksionale, përgjegjësi, strukturës dhe personelit;
- forcimit të funksionit të Agjencisë, në zbatim të parimeve të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut;
- rritjes së kapaciteteve të Agjencisë për një qasje proaktive ndaj fenomeneve korruptive të subjekteve;
- parandalimit, zbulimit, dokumentimit dhe hetimit paraprak të veprimtarisë kriminale e korruptive, në subjektet e saj;
- përmirësimit të infrastrukturës teknologjike të Agjencisë për t'iu përgjigjur dinamikës dhe kërkesave në rritje.

Gjithashtu, Agjencia, ka zgjeruar dukshëm objektin e veprimtarisë së saj, duke përfshirë:

- vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të strukturave, si detyrime të lindura me ndryshimet e fundit legislative e konkretisht ligji nr. 12/2018, i ndryshuar, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
- procesin e aplikimit dhe verifikimit për pajisjen me Certifikatë të Sigurimit të Personelit për subjektet e Agjencisë.
- Ekzaminimin poligrafik.
- Hetimit disiplinor të subjekteve.



II. VLERËSIMI I SITUATËS

Veprimtaria e strukturave të Agjencisë përgjatë vitit 2021, krahas përpjekjeve për të realizuar dhe përmbytur misionin dhe objektin e veprimtarisë së saj, është fokusuar në përmbyturjen dhe zbatimin e objektivave e masave të përcaktuara në dokumentin “Politikat prioritare në fushën e rendit dhe sigurisë” të Ministrisë së Brendshme si dhe të dokumentave konkrete të nivelit strategjik si;

- Strategjia për Zhvillimin e SHÇBA-së dhe Plani i Veprimit 2020 - 2024,
- Strategjia Kombëtare Anti-Korrupsion 2015 – 2020 dhe Plani i Veprimit 2020 – 2023
- Plani Kombëtar për Integrimin European PKIE, 2020 – 2022”.

Ndërkohë në vëmendje ka qenë edhe vazhdimi i procesit reformues të institucionit, si nëpërmjet hartimit të legjislacionit të ri të nevojshëm, ashtu edhe për reformimin strukturor e funksional të saj, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së punës.

Veprimtaria dhe përmbyturja e përgjegjësiave institucionale dhe funksionale të strukturave të Agjencisë gjatë periudhës raportuese është ndikuar nga një sërë faktorësh dhe rrethanash të situatave të brendshme dhe të jashtme, si “Pandemia e krijuar nga Covid -19”, “Zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021”; etj. dhe pa ulur asnjëherë ritmin e punës, por duke e orientuar dhe drejtuar në çështje e problematika parësore.

III. REALIZIMI I PRIORITETEVE & OBJEKTIVAVE TË PLANIFIKUARA

- Miratimi i ligjit nr. 128/2021 për “Agjencinë e Mbrojtjes Policore”;
- Ndjekja dhe zbatimi i masave dhe aktiviteteve të parashikuara në dokumentet strategjike:
 - “Strategjia e Zhvillimit të Shërbimit 2020 – 2024 & Plani i Veprimit 2020 – 2022”
 - Programi Vjetor i Punës së Shërbimit 2021;
- Implementimi dhe vënia në efikasitet të plotë të “Sistemit të Menaxhimit të Çështjes/ Moduli i Ankesave & Hetimit Procedural Penal”;
- Implementimi i “Sistemeve të reja analitike të informacionit iBase & i2 Analyst Notebook” në 7 Drejtoritë Rajonale, Drejtorinë e Hetimit dhe Drejtorinë e Analizës;
- Ndjekja dhe zbatimi i projektit “Mirëmbajtja e rrjeteve dhe sistemeve të Shërbimit” për një periudhë 3-vjeçare;
- Implementimi i “Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore” (HRMIS) për administrimin e të dhënave të personelit;
- Përfundimi i Projektit për “Rikonstruksionin e godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit”; zyra dhe ambjente të reja pune;
- Realizimi i Projektit “Mobilimi i godinës së SHÇBA-së”, me afat 2–vjeçar, për mobilimin e strukturave në nivel qendror dhe vendor;
- Realizimi i Projektit “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit në SHÇBA”, me afat 3 – vjeçar, për sigurimin e shërbimit të printimit, në qendër dhe në çdo post në Drejtoritë Rajonale.

IV. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN & BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME SHËRBIMET HOMOLOGUE

- AMP, si pjesë e administratës publike dhe një agjenci ligjzbatuese me kompetenca mbikëqyrëse dhe kontrolluese, ndaj subjekteve, objekt i veprimtarisë së tij, ka qenë pjesë e angazhimeve të Ministrisë së Brendshme dhe Qeverisë Shqiptare në funksion të proceseve integruese të Shqipërisë në BE, konkretisht:
 - *Përfaqësimi në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitujt “Kriteri Politik” e “Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut”, ku institucion lider është Ministria e Drejtësisë.*
 - *Raportimi mbi treguesit statistikor të Agjencisë në kuadër të raportimit javor për Kryenegociatorin e Shqipërisë, mbi ecurinë e përmbushjes së kushteve dhe rekomandimeve për procesin e negociimit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.*
 - *Raportimi në kuadër të Raport Progresit të BE-së për Shqipërinë, viti 2021.*
 - *Raportimi dhe kontributi i Agjencisë në përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 – 2013.*
 - *Raportimi dhe kontributi i Agjencisë në përmbushjen e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian 2021 – 2023 (PKIE).*
 - *Raportimi dhe kontributi i Agjencisë në përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga GRECO, në Raportin e Raundit të V të Vlerësimit për Shqipërinë.*
 - *Raportimi dhe kontributi i Agjencisë në kuadër të takimit të 13-të Shqipëri – Bashkim Evropian të Nënkomitetit “Drejtësia, Liria, Siguria”.*
 - *Raportimi dhe kontributi i Agjencisë në kuadër të “Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021 – 2023”*
 - *Raportimi dhe kontributi i Agjencisë në kuadër të Pyetësorit TIP Report 2021 të DASH për “Trafikimin e Personave”, etj.*
- Agjencia është pjesë e **Rrjetit të Vendeve Partnere kundër Korrupsionit (EPAC/ EACN)** të BE, që prej vitit 2010. Angazhimi i AMP në këtë rrjet përgjatë vitit 2021 është fokusuar në:
 - *Shkëmbimin e informacionit e praktikave më të mira, në funksion të hartimit të “Manualit për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit” për vendet anëtare të EPAC/EACN në Bashkimin Evropian.*
 - *Pjesëmarrjes në Konferencën Vjetore të Punës së EPAC, mbajtur në Vilnues të Lituanisë.*
- Agjencia është pjesë e **platformës rajonale Anti – Korrupsion për Departamentet e Kontrollit të Brendshëm** të agjencive ligjzbatuese dhe të kufirit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ngritur me ndihmën dhe asistencën e OSBE në Shqipëri.

Gjatë këtij viti është marrë pjesë në takimet/tryezat e punës të organizuara brenda dhe jashtë vendit në kuadër të kësaj platforme, me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira në fushën e kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes së jashtme policore ndër vendet anëtare dhe atyre të BE-së.
- Agjencia vazhdon të jetë pjesë e **Grupit të Punës pranë DSIK**, në kuadër të procesit të Vettingut të “Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” sipas ligjit nr. 84/2016.

Është vazhduar të merret pjesë në takimet e grupit të punës për ndjekjen e procesit në lidhje me shtyllën e “kontrollit të figurës” të subjekteve të ligjit nr. 84/2016, bazuar në kërkesat e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) si dhe në takimet e KDZH për deklasifikimin e plotë dhe të pjesshëm të “Raporteve për Kontrollin e Figurës për subjektet e rivlerësimit”.
- Agjencia është pjesë e **Grupit të Punës Ndërinstitucional** për implementimin dhe ndjekjen e zbatimit të prioritetëve dhe objektivave të “Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit 2020 – 2021”. Përgjatë vitit 2021 janë zhvilluar:
 - *aktivitete nga Misioni PAMECA V, në kuadër të implementimit të këtij plani, në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit gjatë muajit Qershor.*
 - *trajnimi në lidhje me Integritetin nga ekspertë të Mbretërisë së Bashkuar.*
 - *raportimi për përmbushjen e detyrimeve që ka Shërbimi në kuadër të këtij plani integriteti dhe planit të veprimit për vitin 2021.*


V. MBIKËQYRJA NËPËRMJET VEPRIMTARISË INSPEKTUESE DHE TRAJTIMIT TË ANKESAVE

V.1. Funksionimi i Linjës së Gjelbër

Nëpërmjet Linjës së Gjelbër 08009090 janë marrë **5713** telefonata, e konkretisht:

- 2039 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së AMP-së.
- 2758 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së AMP-së. Shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse për të depozituar ankesën e tyre.
- 902 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e AMP-së.

Telefonatat 2019 - 2021



Rritja në numër e telefonatave përgjatë vitit 2020 ka ardhur për faktin e situatës së pandemisë dhe kufizimeve të lëvizjeve, ku në pamundësi komunikimi me policinë në numrat e emergjencës 129 dhe 112, shtetasit i janë drejtuar linjës së gjelbër **0800 90 90** për informacion.

Rritja e besimit të qytetarit tek Agjencia n'a obligon për vlerësimin në kohë reale të ankesave/denoncimeve të tyre dhe realizimit të procesit të verifikimit duke dhënë përgjigjen e duhur qytetarit si dhe rrugën e zgjidhjes kur ajo ka të bëjë me institucione të tjera ligjzbatuese.

V.2. Administrimi i Ankesave


Një nga prioritetet e veprimtarisë së Agjencisë mbetet përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, me fokus kryesor administrimin dhe trajtimin me objektivitet dhe paanshmëri të ankesave ndaj punonjësve të strukturave objekt i punës së AMP-së. Në sistemin e Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Ankesave janë administruar **1694** Ankesa. Ky sistem ka mundësuar rritjen e cilësisë së hetimeve administrative nëpërmjet mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë në kohë dhe hapësirë, krijimit të një historiku në lidhje me ankesat dhe mënyrën e trajtimit të tyre si dhe rritjen e transparencës dhe performancës së Shërbimit në publik.



V.3. Ankesat sipas Shërbimeve të Strukturave, subjekte të Agjencisë


Trendi i ankesave të ardhura pranë Agjencisë, nëpërmjet të gjitha portave të vëna në dispozicion për publikun dhe jo vetëm, sipas shërbimeve të strukturave, subjekte të veprimtarisë së Agjencisë, reflektohet në % në grafikun si vijon:

Trendi i ankesave sipas shërbimeve




Ky grafik evidenton sërish, ashtu si në vitet e kaluara, se strukturat për të cilat rezultojnë të ketë një numër më të madh ankesash janë strukturat e shërbimeve të sigurisë publike me 47% të totalit; policia rrugore me 27% e hetimi i krimit me 19%, si struktura që kanë kontakt të drejtëpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me qytetarët dhe problematikat e tyre, duke i evidentuar edhe si strukturat më të riskuara në aspektin e veprimeve korruptive.

V.4. Ankesat sipas kategorisë së shkeljeve



Të dhënat e pasqyruara në këtë grafik, ashtu edhe në atë krahasimor, për periudhën 3 vjeçare (2019 –2021), evidentojnë se trendi i shkeljeve të mundshme të kryera nga punonjësit e strukturave, të adresuara nëpërmjet denoncimeve të publikut pranë AMP-së, vazhdon të jetë “mosveprimi i strukturave”; “gjobë e padrejtë”; “shkelje e procedurave standarde të punës”; “veprime arbitrare”; “shpërdorim detyre”; “shkelje e kodit të etikës”, etj”.

Tregues krahasimor sipas llojit të shkeljes



Ky trend i paligjshmërive të mundshme të kryera nga punonjësit e strukturave, i korrespondon edhe trendit të ankesave sipas shërbimeve, ku evidentohen si strukturat kryesore; siguria publike; policia rrugore dhe strukturat e hetimit të krimit. Kjo përputhshmëri ndërmjet llojit të shkeljes dhe strukturës që ka kryer shkeljen, lidhet me natyrën e problematikave që trajtojnë këto lloje shërbimesh në kontakt të drejtëpërdrejtë me qytetarin, siç janë konfliktet e llojeve të ndryshme, të zakonshme në jetën komunitare.

V.5. Përfundimet e Hetimit Administrative të Ankesave

Viti	Raste penale nga ankesat	Hetime disiplinore nga ankesat
2019	3 raste	118 raste me 215 punonjës të strukturave
2020	10 raste me 29 punonjës policie	97 raste me 191 punonjës të strukturave
2021	6 raste me 14 punonjës policie	59 raste me 105 punonjës të strukturave

V.6. Problematikat e konstatuara gjatë trajtimit të ankesave

Nga hetimi administrativ i ankesave, si një nga metodat mbikëqyrëse të veprimtarisë dhe performancës së strukturave, objekt i veprimtarisë së Agjencisë ka rezultuar se punonjësit e strukturave të sigurisë publike, policisë rrugore dhe të hetimit të krimit shfaqin mungesë etike dhe profesionalizimi, por shqetësuese mbeten veprimet e paligjshme kryesisht të strukturave të sigurisë publike në shoqërimet e paligjshme, në ushtrimin e dhunës ndaj shtetasve gjatë shoqërimit dhe qëndrimit në ambientet policore.

V.7. Veprimtaria Inspektuese

Në funksion të vlerësimit të performancës, nëpërmjet hetimit administrativ të inspektimeve, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar **110 inspektime në 72 struktura** subjekte të Agjencisë.



43 inspektime të planifikuara në planin vjetor 2021

67 inspektime të paplanifikuara, të iniciuara nga ngjarjet e ndodhura, publikimet në media dhe problematika të raportuara nga qytetarë ose institucione të ndryshme

- ❖ Në përfundim të hetimit administrativ të inspektimeve, ka rezultuar se:
 - Janë dhënë **439 rekomandime** për përmirësim të poblematikave të evidentuara,
 - Në **1 rast janë referuar materialet** proceduriale në Prokurori,
 - Në **42 raste për 288 punonjës** të policisë është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor, ku sipas niveleve i klasifikojmë në:
 - **1** punonjës policie i nivelit drejtues
 - **108** punonjës policie të nivelit të parë drejtues
 - **179** punonjës policie të nivelit zbatues
- ❖ Sipas kategorisë së Shërbimeve të Inspektuara rezulton se strukturat me numrin më të lartë të inspektimeve të planifikuara apo të paplanifikuara janë:
 - strukturat e hetimit të krimit me 50 inspektime,
 - strukturat e rendit me 41 inspektime,
 - strukturat e policisë rrugore me 10 inspektime,
 - strukturat e kufirit&migracionit me 7 inspektime,
 - strukturat e shërbimeve mbështetëse me 3 inspektime,
 - strukturat e MNZSH me 2 inspektime,
 - të gjitha shërbimet në nivel strukturor (inspektim i performancës), 1 inspektim,

Në aspekt krahasimor për periudhën 2019 – 2021 veprimtaria inspektuese paraqitet si vijon:

Viti	Inspektime			Referime	Rekomandime	Masa disiplinore	Të përbashkët
	Planifikuar	Paplanifikuar	Total				
2019	10	63	73	9 (30 persona)	181	265	13
2020	29	59	88	2 (pa autor)	282	89	28
2021	43	67	110	1 (pa autor)	439	288	32

V.8. Problematikat e konstatuara në inspektimet e zhvilluara

Problematikat e konstatuara në inspektimet e zhvilluara kanë të bëjnë me moszbatimin e procedurave standarde të punës, shkelje të të drejtave të personave që shoqërohen apo arrestohen/ndalohen në ambientet policore, veprime arbitrare, tregues të ulët të performancës në punë, vlerësim të pamjaftueshëm të detyrimeve që rrjedhin nga Programet e Punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si:

- në luftën ndaj kultivimit të bimëve narkotike;
- krimeve mjedisore;
- përmirësimin e treguesve të sigurisë rrugore;
- masat e sigurisë në rastet e festave, sezonit turistik;
- shkelje e akteve ligjore e nënligjore në rekrutimin e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit, etj.

Në shumë raste është konstatuar papërgjegjshmëri dhe mosushtim i kompetencave menaxheriale nga drejtuesit e strukturave në të gjitha nivelet.

VI. MBIKËQYRJA NËPËRMJET HETIMIT PROCEDURAL PENAL

Gjatë vitit 2021, në funksion të forcimit të kapaciteteve të brendshme të strukturave të hetimit dhe për të përballuar impaktin e faktorëve të jashtëm në veprimtarinë e përditshmërisë së strukturave të hetimit, janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm 26 akte normative, nga të cilat:

- 18 Urdhra,
- 5 qarkore,
- 2 Tërheqje Vëmendje,
- 1 Përgjithësim

Për një periudhë 3 - vjeçare, mbështetur në Planet Vjetore, në orientimet e Programeve të Ministrit të Brendshëm sipas përkatësisë, apo dhe në dokumentet e tjera të karakterit strategjik, Agjencia ka monitoruar dhe mbikëqyrur subjektet e saj, kryesisht organizatën e Policisë së Shtetit, në lidhje me paligjshmëritë dhe fenomenet negative më kryesore që shfaqen në radhët e tyre.

Metodat, format e monitorimit dhe të mbikëqyrjes kanë qenë të larmishme dhe gjithnjë të mbështetura në bazën ligjore. Ato kanë pasur për qëllim, evidentimin e shfaqjeve të paligjshmërive, të strukturave më tipike ku manifestohen episode korruptive, të fiksimit të mekanizmit të kryerjes, të nivelit hierarkik dhe zinxhirit të komandës nga lartë-poshtë dhe anasjelltas përsa i përket thellësisë së konsumimit të akteve korruptive, etj. Metodat kryesore të aplikuara, kanë qenë;

- grumbullimi dhe verifikimi i informacionit,
- regjistrimi i hetimeve proaktive në prokurori,
- kryerjes së inspektimeve,
- trajtimit të ankesave

Këto metoda kanë dhënë mjaftueshëm qartësinë për evidentimin e fenomeneve më tipike që bashkëjetojnë, krahas gjithë punës pozitive që kryejnë këto organizata, në përmbushjen e detyrës dhe misionit ligjor të tyre. Krahas këtyre metodave, rezultat kanë dhënë edhe realizimi i vrojtimeve apo inspektimeve me objekt konkret, ku është arritur që të merren të dhëna me interes në drejtim të plotësimit të tablosë së mësipërme. Qëllimi kryesor i evidentimit të fenomeneve negative e korruptive, është jo vetëm njohja e tyre, por në radhë të parë i shërben përcaktimit të politikave parandaluese e më pas edhe përcaktimi i prioritetëve dhe objektivave për luftën e përditshme në interes të minimizimit të tyre në radhët e organizatës së Policisë së Shtetit.

Edhe gjatë këtij viti, pavarësisht faktorëve objektivë që kanë ndikuar në veprimtarinë e strukturave, subjekte të Shërbimit, në veçanti ato të Policisë së Shtetit, si strukturat në kontakt dhe në shërbim të publikut, janë evidentuar fenomene të paligjshmërisë, të cilat kanë pasur tipare pothuajse të përbashkëta me periudhat e mëparshme.

Duke u bazuar tek analiza e informacioneve të administruara nga shumë burime, të grumbulluara nga vetë AMP, nga agjencitë e tjera ligjzbatuese, por dhe të ardhura edhe nga shtetas fizik e subjekte private e publike, është bërë e mundur çelja e shumë hetimeve penale, administrative ndaj ankesave dhe e kryerjes së inspektimeve. Tehu kryesor kanë qenë hetimet proaktive në përdorim të Metodave Speciale të Hetimit dhe ato të referuara e të deleguara për përfundim të tyre nga strukturat tona.

**224 referime penale
për 329 persona**

- **88** punonjës policie i nivelit të parë drejtues,
- **223** punonjës policie të nivelit zbatues,
- **10** punonjës civil (administrativ),
- **3** efektiv të Gardës,
- **5** PMNZSH dhe
- **61** shtetas.

Strukturat e Hetimit të Agjencisë në nivel vendor apo qendror në interes të dokumentimit të ngjarjeve që kanë ndodhur në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, PMNZSH-në, etj, kanë realizuar dhe veprime me iniciativë ku kanë kryer arrestime/ndalime në flagrancë për **30 punonjës** të strukturave e **26 shtetas**.

Është për t'u theksuar se në këto veprime në asnjë rast nuk është evidentuar paligjshmëri gjatë vlerësimit të masave të sigurimit nga prokuroritë dhe gjykatat.

Janë zbatuar vendime të gjykatave për masat e sigurimit personal për **100 persona** nga të cilët **69 subjekte** të Shërbimit dhe **31 shtetas**.

Sipas masave të sigurimit personal të dhena nga gjykatat ato kanë qenë si vijon:

Masa e sigurimit personal **“arrest në burg”** caktuar për **53 persona**

- 9 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 17 punonjës policie të nivelit zbatues
- 27 shtetas

Masa e sigurimit personal **“arrest në shtëpi”** caktuar për **3 persona**

- 1 punonjës policie i nivelit të parë drejtues
- 2 punonjës policie të nivelit zbatues

Masa e sigurimit personal **“detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”** për **17 persona**

- 2 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 11 punonjës policie të nivelit zbatues
- 4 shtetas

Masa e sigurimit personal **“pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”** për **27 persona**

- 10 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 17 punonjës policie të nivelit zbatues

Të dhënat evidentojnë se nga njëra masë tek tjetra, qofshin ato të karakterit ndalues e shtrëngues, paligjshmëria gjatë ushtrimit të detyrës në format e saj është arritur të dokumentohet me prova dhe krijuar dyshimin e arsyeshëm, kryesisht për punonjës të nivelit zbatues me rreth 68.2% të totalit të punonjësve me masa sigurie kundrejt 31.8% të punonjësve të nivelit të parë drejtues.

Të grupuara sipas veprave penale, 224 referimet penale për 329 subjekte, i klasifikojmë në:

- 69 referime ndaj 129 punonjës të strukturave dhe 9 shtetas për veprat penale të *“shpërdorim detyre”* e *“korrupsioni pasiv”*,
- 14 referime ndaj 29 punonjës të strukturave dhe 24 shtetas për veprën penale *“shpërdorim detyre”* duke favorizuar *“kultivimin e bimëve narkotike”*,
- 9 referime ndaj 15 punonjës të strukturave dhe 7 shtetas për veprat penale *“shpërdorim detyre”* dhe favorizim të *“ndërtimeve pa leje”*,
- 29 referime ndaj 39 punonjësve të strukturave dhe 14 shtetas për veprat penale *“shpërdorim detyre”* duke favorizuar *“kontrabandën”*, *kalimin e paligjshëm të kufirit”* e *“trafikut të drogës”*,
- 17 referime ndaj 19 punonjësve të strukturave, për veprat penale *“falsifikimit të dokumenteve”*, *“vjedhjes”*, *“vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”*,
- 27 referime ndaj 39 punonjësve të strukturave, për veprën penale të *“kryerjes së veprimeve arbitrare”*;
- 31 referime ndaj 34 punonjësve të strukturave dhe 3 shtetas, për veprat penale *“dëmtime të tjera me dashje”*, *“dhunë në familje”*, *“goditje për shkak të detyrës”*, etj,
- 24 referime ndaj 22 punonjësve të strukturave dhe 3 shtetas për veprat penale *“shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”* e *“drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt”*;
- 4 referime ndaj 3 punonjësve të strukturave *“për vepra të tjera penale”*;


Këto të dhëna reflektojnë pothuajse të njejtën tendencë të formave dhe fenomeneve të paligjshmërisë të evidentuar ndër rradhët e strukturave si në vitet e mëparshme, por duhet të veçohen në % relativisht të lartë rreth **11.5 % të totalit** krahasuar me periudha të mëparshme, **rastet e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor** nga vetë punonjësit e policisë, me pasoja si materiale ashtu dhe në njerëz, në kushtet kur pjesa dërmuese e punonjësve ka qenë nën efektin e pijeve alkoolike shumë herë mbi kufirin e lejuar.

Rritje e kapaciteteve të Policisë Gjyqësore në hetimin penal të implikimeve duke synuar në rritje cilësore të hetimeve proaktive me SPAK, si dhe me prokuroritë e zakonshme; për vitin 2021 kemi patur këto rezultate;




- rritje me **4.6 % të referimeve** penale të kryera,
- rritje me **3.7 % të numrit** të subjekteve të procedural penalisht,
- rritje me **13.1 % të numrit** të subjekteve ndaj të cilëve janë ekzekutuar vendimet e gjykatave për masa sigurie,
- rritje me **54.5 % të hetimeve** proaktive,


Tregues krahasimorë për Nr. e referimeve penale



Tregues krahasimorë për Nr. punonjësve të referuar




Nr. subjekteve të arrestuar/ndaluar/masë sigurie



VI.1. Operacione/Procedime Penale të suksesshme gjatë vitit 2021

Nga strukturat e hetimit të Agjencisë janë kryer disa operacione të suksesshme për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format e “korrupsionit pasiv”, “shpërdorimit të detyrës”, favorizimit të “kultivimit të bimëve narkotike”, “kontrabandës” dhe tendencave të tjera, e konkretisht:



VI.2. Ndarja dhe klasifikimi i veprave penale sipas hierarkisë & nivelit të menaxhimit

Ndarja dhe niveli i gradave, në strukturat e Policisë së Shtetit përcakton kompetencën e veprimit dhe nivelit të menaxhimit, ku;

Roli zbatues – përfshin punonjësit e policisë që përfaqësojnë nivelin bazë të veprimit, ata që janë në vijë të parë të veprimit dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun.

Roli i parë drejtues – përfshin punonjësit e policisë që përfaqësojnë nivelin taktik të drejtimit dhe veprimin teknik operacional, kryesisht funksionet e specialistit, shef seksioni/sektori, shef komisarati apo dhe zv/drejtor e drejtor drejtorie.

Roli i mesëm drejtues – përfshin punonjësit e policisë që përfaqësojnë nivelin e menaxhimit ekzekutiv qëndror dhe/ose vendor, kryesisht funksionet e zv/drejtor e drejtor drejtorie në nivel vendor dhe qëndror.

Analizimi i treguesve statistikor të paraqitur në tabelën e mëposhtme reflekton këtë shkallë implikimi në format e paligjshmërisë, ku;

- Shkallë më lartë e paligjshmërisë me 58.5 % të numrit në total të punonjësve të implikuar, evidentohet në nivelin e vijës së parë të reagimit dhe veprimit që përbëhet nga *punonjësit e strukturave vendore në Komisaritet e Policisë apo Stacionet e Policisë*. Funksionet kryesore të këtyre strukturave janë ato të patrullës së përgjithshme; ndihmës specialisti në zonë (SPZ); qarkullimit rrugor, ndihmës specialist/kontrollor; ndihmës specialist/ policimi në Komunitet, etj.
- Zinxiri komandues si (*shefat e rendit; të hetimit të krimeve; të policimit në komunitet, të strukturave të qarkullimit rrugor; apo të kufirit, shef komisarati*), zbresin një shkallë më poshtë me 23.1 % të numrit në total të punonjësve të përfshirë dhe implikuar në veprimtari të kundërligjshme.

VI.3. Trendi i formave të paligjshmërive të evidentuara në periudhën 2019 - 2021

Viti	Nr. referimesh	Shpërdorim detyre & korrupsion	Shpërdorim detyre ¹ & kultivim të bimëve narkotike	Shpërdorim detyre ² & trafik të ndryshme	Kryerje e veprimeve arbitrare	Shkelje të Kodit rrugor	Vepra të tjera penale
2019	250	111	31	50	45	3	10
2020	214	64	33	51	23	10	11
2021	224	69	14	55	52	27	8

¹ Shpërdorim detyre duke favorizuar veprimtarinë e kundërligjshme të kultivimit të bimëve narkotike

² Shpërdorim detyre duke favorizuar veprimtaritë e kundërligjshme si trafik droge, kontrabandë, kalim i paligjshëm i kufirit, fallsifikimit, mashtrim, etj.

VII. ANALIZA E INFORMACIONIT KRIMINAL, SHFRYTËZIMI I PROGRAMEVE BASHKËKOHORE TË ANALIZËS

- Sistemi i Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Hetimit Procedural Penal ku janë administruar çështjet penale të referuara nga strukturat hetimore të nivelit vendor e qëndror të Agjencisë, është shfrytëzuar në prodhimin e statistikave periodike në funksion të Analizave e Raporteve të Treguesve të Performancës.
- Platforma i2 Analyst Notebook është shfrytëzuar për prodhimin e produkteve analitike sipas kërkesave të strukturave të hetimit, në funksion të hetimit procedural penal në ndjekje nga ana e tyre.
- Është punuar në bashkëpunim me Sektorin e IT-së për përshtatjen e Databazës Analitike të të dhënave (ibase) sipas kërkesave dhe dokumentacionit që parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë informativo – gjurmuese dhe hetimit procedural penal.

VII.1. Mbikëqyrja nëpërmjet veprimtarisë së Sigurimit të Personelit (CSP)

Agjencia ka organizuar dhe ndjekur punën për procesin e verifikimit të praktikave në kuadër të aplikimit të personave për CSP, të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve sipas ligjit 84/2016, të procesit të rivlerësimit të strukturave sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016. Përgjegjësia ligjore dhe funksionale e Agjencisë, si një nga tre Autoritetet Verifikuese në vend, mbi pastërtinë e figurës së subjekteve të strukturave, objekt i veprimtarisë së Agjencisë, e jo vetëm si dhe vlerësimit dhe gjykit mbi indikatorin e “besueshmërisë” dhe nivelit të tij për ecurinë e mëtejshme në karrierë është e reflektuar në procedurat verifikuese të sigurimit të personelit, ku gjatë 2021, janë vlerësuar praktikatat për:

- **2245 punonjës** të Policisë së Shtetit
- **37 efektivë** të Gardës së Republikës
- **860 punonjës** të Operatorëve Ekonomikë
- **2667 punonjës** të Institucioneve Shtetërore
- **551 prokurorë/gjyqtarë/institucionet e reja të drejtësisë**

Në tabelën e mëposhtme, të dhëna krahasimore ndërmjet viteve 2019 – 2021;

Periudha	Subjektet e Agjencisë			Operatorët Ekonomikë (stafi)	Institucionet Shtetërore (punonjës)	Institucionet e drejtësisë/prokurorë/gjyqtarë
	Punonjës të Policisë së Shtetit	Punonjës të Gardës së Republikës	Punonjës të PMNZSH			
2019	1615	80	-	739	1408	32
2020	1399	17	-	794	2334	395
2021	2245	37	-	860	2667	551

Në përfundim të procedurave verifikuese për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së Agjencisë, janë adresuar pranë DSIK me vlerësimin “që përbëjnë rrezik për pajisjen me CSP, të subjekteve të Agjencisë”, në kuadër të aksesit dhe njohjes me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror” për:

- Vitin **2019** - **127 punonjës, subjekte të Shërbimit**
- Vitin **2020** - **115 punonjës, subjekte të Shërbimit**
- Vitin **2021** - **61 punonjës, subjekte të Shërbimit**

Nga ana e DSIK jemi njoftuar për refuzimin/pezullimin për pajisje me CSP, për:

- Vitin **2019** - **35 punonjës, subjekte të Shërbimit**
- Vitin **2020** - **75 punonjës, subjekte të Shërbimit**
- Vitin **2021** - **57 punonjës, subjekte të Shërbimit**



VIII. INTEGRITETI/VETINGU I PUNONJËSVE TË AMP-SË DHE PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE

- ❖ Personeli i Agjencisë është subjekt i ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar & Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar. Gjatë këtij viti ka filluar prej Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (KJV) procesi i vlerësimit kalimtar për **42 punonjës** të Agjencisë, anëtarë të trupave vlerësuese, ku deri më tani, për:
 - 13 punonjës është vendosur “konfirmim në detyrë”
 - 2 punonjës është vendosur “ndjekje e trajnimit profesional”
 - 2 punonjës është vendosur “ndërprerje e procesit të vlerësimit”
 - 1 punonjës është vendosur “përfundim nga detyra”.
- ❖ Referuar përgjegjësi të reja të përcaktuara në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, Agjencia është ngarkuar me detyrimin e vlerësimit kalimtar dhe periodik të subjekteve të këtij ligji dhe kryerjen e ekzaminimeve poligrafike kalimtare dhe periodike për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Krahas iniciativave organizative e funksionale të ndërmarra përgjatë vitit 2020, edhe këtë vit ka vazhduar puna për plotësimin e të gjithë kuadrit ligjor, me akte nënligjore në zbatim të këtij ligji, konkretisht:
 - Draftimi i Akt–Marrëveshjeve mbi “Përcaktimin e modaliteteve të shkëmbimit të informacionit nëpërmjet Agjencisë dhe institucioneve ligjzbatuese, në funksion të realizimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik”.
 - Draftimi i modeleve të shkresave zyrtare të korespondencës me institucionet shtetërore, personat privat dhe publik, për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit kalimtar & periodik.
 - Draftimi i projekt - ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar”, me synimin rregullimin e disa procedurave dhe standardeve që lidhen me:
 - adresimin e problematikave të evidentuara në ligjin aktual;
 - adresimin dhe implementimin e rekomandimeve të GRECO-s, në lidhje me kufizimin e subjekteve që do i nënshtrohen vettingut, bazuar në dy elemente, gjatë ngritjes në detyrë, dhe me analizë risku për struktura dhe funksione të ekzpozuar nga korrupsioni;
- ❖ Veprimtaria e strukturës së poligrafit është fokusuar në disa drejtime, që lidhen me përmirësimin e akteve nënligjore mbështetëse që normojnë e rregullojnë veprimtarinë e kësaj strukture, në kryerjen e ekzaminimeve poligrafike dhe ngritjes profesionale dhe kapaciteteve të kësaj strukture, konkretisht:
 - **Kryerja e ekzaminimeve poligrafike për 75 kandidatët për Hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit, në periudhën 9 – 26 Gusht 2021.**
 - **Kryerja e 50 ekzaminimeve poligrafike testuese**, të cilat kanë shërbyer në rritjen e profesionalizmit të ekzaminuesve dhe përditësimin e këtyre njohurive sipas standardeve Ndërkombëtare të vendosura.

IX. MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

IX.1. Për menaxhimin e shërbimeve logjistike & IT-së

- Hartimi i Projekt – Kërkesave për Shërbimet Logjistike
- Hartimi i PBA-së 2022 – 2024 dhe përgatitja e fish-projekteve për investimet
- Hartimi i Regjistrimit të Parashikimit të Prokurimeve, krijimi në faqen e APP dhe ndjekja e realizimit
- Miratimi i Procedurave Standarde dhe Përshkrimeve të Punës për shërbimet logjistike
- Miratimi i Procedurave Standarde të Punës së strukturës së Teknologjisë së Informacionit
- Kryerja e inventarizimit të armatimit dhe të gjitha aseteve të tjera qarkulluese të Agjencisë
- Hartimi i akteve administrative për menaxhimin e përdorimin e mjeteve të transportit
- Implementimi dhe vënia në funksionim e platformës “i2 Analyst Notebook”
- Implementimi dhe vënia në funksionim e “Sistemit të Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Ankesave & Hetimit Procedural Penal”
- Ndjekja e kontratës “Për mirëmbajtjen e rrjeteve dhe sistemeve të Shërbimit” për periudhën 3 vjeçare.
- Kryerja e 30 procedurave të prokurimit, nga të cilat 2 me praktikë sekrete, 2 me procedurë të hapur, 26 procedura me blerje të vogla nëpërmjet sistemit të APP-së. Gjatë gjithë procesit të prokurimeve nuk ka patur asnjë ankimim nga operatorët ekonomik.

Ndër më kryesorët, sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti i Prokurimit	Kontratë	Tipi i Kontratës	Fondi i përlllogaritur	Statusi ku ndodhet procedura	Lloji i procedurës së prokurimit
Blerje programi	Kontratë	Shërbim	8,418,000	realizuar	Procedurë sekrete
Analizim të dhënash,	Kontratë	Shërbim	350,160	realizuar	Prokurim me vlerë të vogël
Mbikëqyrje e punimeve të Rikonstruksionit të Godinës së SHÇBA	Kontratë	Shërbim	49,000	realizuar	Prokurim me vlerë të vogël
Kolaudim punimeve të rikonstruksionit të godinës	Marrëveshje kuadër	Marrëveshje kuadër	10,000,000	realizuar	Procedurë e hapur
Mobilim i godinës së SHÇBA	Kontratë në vazhdim	Procedurë e hapur	15,544,000	realizuar	Procedurë e hapur, kontratë në vazhdim
Rikonstruksion i Godinës së SHÇBA					

IX.2. Për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimeve

- Rekrutime
 - 1 punonjës administrative
- Largime, përjashtim, lirim nga puna
 - Janë larguar nga detyra 12 punonjës me motivacione të ndryshme, ku:
 - 8 punonjës me motivacionin “Me kërkesën e tij”;
 - 1 punonjës është “Përjashtuar nga Shërbimi” me vendim të K.J.V.

- 2 punonjës janë “Liruar nga detyra”, pasi ju është hequr “CSP”;
- 1 punonjës ka “ndërruar jetë”.
- Emërimet, caktim i përkohshëm në detyrë dhe transferime
 - Janë transferuar 46 punonjës të Agjencisë
 - Janë komanduar në detyrë për nevojë pune 6 punonjës të Agjencisë.
- Edukimi, trajnimi i vazhdueshëm i personelit

Në kuadër të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të brendshme, janë zhvilluar rreth 20 trajnime dhe seminare me tematikë të ndryshme me pjesëmarrjen e rreth 80 punonjësve të Agjencisë, të organizuara nga partnerët tanë brenda dhe jashtë vendit si; IBM, ICITAP, Ministria e Brendshme Turke, DSIK, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, ASPA, CIDS, PAMECA, DCAF, etj.

- Shkeljet dhe hetimi disiplinor

Në funksion të mekanizmave të vetëkontrollit të brendshëm, të vlerësimit të performancës së gjithësecilit nga punonjësit e personelit të Agjencisë, evidentimit të shkeljeve të lehta apo të rënda disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës funksionale, gjatë vitit, janë dhënë 10 masa disiplinore të lehta dhe të rënda për 12 punonjës, e konkretisht:

- 8 punonjës me masë disiplinore “Vërejtje”
- 1 punonjës me masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”
- 1 punonjës me masë disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit deri në 12 muaj”
- 2 punonjës me masë disiplinore “Përfshirje nga Shërbimi”
- Shpërblime dhe rritje pagash
 - Bazuar në VKM, nr.149 datë 18.02.2015, pika 4, i ndryshuar, janë shpërblyer “për arritje dhe rezultate të larta në punë” disa punonjës me gradë të Agjencisë.
 - I gjithë personeli i AMP-së u shpërblye në fund të vitit me 1 (një) pagë mujore, vlera e të cilit arrit në masën 12 milionë lekë.

IX.3. Performanca financiare

Për vitin 2021, Agjencisë i janë akorduar fonde buxhetore në shumën prej 263,333,160 lekë (duke përfshirë ndryshimet gjatë vitit). Ky fond është realizuar në shumën prej 260,653,268 lekë ose në masën 99%.

Pasqyra përmbledhëse e realizimit të shpenzimeve buxhetore të artikujve kryesor të strukturës buxhetore;

(në lekë)

Nr.	Art.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Real. në %
1.	600	Paga & shpenz. personeli	168,944,000	168,454,204	489,796	99.8%
2.	601	Sigurime shoqërore	26,200,000	26,043,878	156,122	99%
3.	602	Mallra e shërbime	29,084,000	27,546,538	1,537,462	95%
4.	606	Transf.buxhetet familjare	4,744,000	4,564,849	179,151	96%
5.	230	Shpenz. për rritjen e aktiveve të trupëzuara	8,418,000	8,266,124	151,876	98%
6.	231	Shpenz. për rritjen e aktiveve të trupëzuara	25,943,160	25,558,740	384,420	99%
TOTALI			263,333,160	260,434,333	2,898,827	99%

X. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2022

Reformimi i institucionit tonë “synon të modelojë organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbikëqyrjen Policore për t’i zhvilluar e përafruar më tej standardet, me ato të vendeve perëndimore në përgjithësi dhe të EPAC (Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit) në veçanti, për të ndërtuar një shërbim publik përfaqësues e me integritet të lartë, të besueshëm nga opinioni publik, transparent dhe efikas për mbrojtjen e ligjshmërisë, interesave të shtetit e komunitetit; si dhe të përcaktojë vizionin, prioritetet e objektivat strategjikë me politikatat dhe alternativat e zhvillimit për të ardhmen”.

Në këtë kontekst, e në analizë të realizimit dhe përmbushjes së prioriteteve dhe objektivave të parashikuara në Dokumentin Strategjik Afatmesëm “Strategjia për Zhvillimin e Shërbimit 2020 – 2024 dhe Plani i Veprimit 2020 – 2022”, por edhe në linjë me Vizionin 2030 të qeverisë shqiptare, viti 2022 do të jetë viti i konsolidimit të Agjencisë së re të Mbikëqyrjes Policore, në aspektin organizativ, funksional dhe strukturor. Prioritetet dhe objektivat kryesore për vitin 2022, të cilat do të zërthehen në aktivitete dhe masa konkrete për të gjitha strukturat në nivel qendror dhe vendor në “Programin Vjetor të Punës së Agjencisë”, janë si më poshtë:

- **Prioriteti I** – Vijimi i konsolidimit organizativ dhe funksional i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet:
 - Hartimi dhe miratimi akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - Rikonceptimi strukturor, në përputhje me autorizimet ligjore/kompetencat dhe funksionet e reja të Agjencisë
- **Prioriteti II** – Rikonceptimi i procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, nëpërmjet:
 - Rishikimit të ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit”, i ndryshuar, bazuar në rekomandimet dhe propozimet e raportit të GRECO, lidhur me me kufizimin e subjekteve që do i nënshtrohen vettingut, bazuar në dy elemente, gjatë ngritjes në detyrë, dhe me analize risku për struktura dhe funksione të ekzpozuar nga korrupsioni
 - Unifikimi dhe standardizimi i procedurave të procesit të vlerësimit, për të shmangur standardin e dyfishtë të trajtimit të rasteve
- **Prioriteti III** – Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve, nëpërmjet:
 - Përmirësimit të shërbimit të pritjes së qytetarëve
 - Rritjes së besimit të publikut tek Agjencia
- **Prioriteti IV** – Rritja dhe forcimi i rolit mbikqyrës të Agjencisë kundër paligjshmërive ndër radhët e strukturave, me fokus të veçantë korrupsionin dhe abuzimin me detyrën, nëpërmjet:
 - Shtimit dhe konsolidimit të instrumentave/mekanizmave të analizës së informacionit kriminal, veprimtarisë informativo-gjurmuese, hetimit administrativ të ankesave & inspektimeve, hetimit penal të shkeljeve, procesit të sigurimit të personelit (CSP), vettingut sipas ligjit nr. 12/2018, për parandalimin, zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së kryer nga punonjës të strukturave;
 - Prodhimit të produkteve analitike duke përdorur programet/sistemet e teknologjive bashkëkohore të informacionit, për çështje të zbatimit të ligjit dhe të parandalimit të shkeljeve gjatë ushtrimit të detyrës nga subjektet;
 - Forcimit dhe rritjes së bashkëpunimit kryesisht me Prokurorinë e Posaçme, Prokuroritë e Shkallës së Parë, Policinë e Shtetit, SHISH, AISM, DSIK, etj, me anë të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe si dhe protokolleve të veprimit.